

**“QASJA E MEDIAS NDAJ  
PERSONAVE ME AFTËSI  
TË KUFIZUARA GJATË  
FUSHATËS ELEKTORALE  
PËR ZGJEDHJET  
PARLAMENTARE  
TË 25 PRILLIT 2021”**

Ky raport është hartuar në kuadrin e projektit “Zgjedhje Gjithëpërfshirëse” të financuar nga qeveria e Mbretërisë së Bashkuar. Përmbajta dhe pikëpamjet e shprehura janë të autorit.

Raporti u përgatit nga Msc. Evis Nasto.

# Tabela e përmbajtjes

	Lista e Figurave.....	4
	Shkurtime .....	5
<b>I.</b>	Hyrja .....	6
	<b>1.1</b> Roli i medias në pasqyrimin e fushatës elektorale .....	6
	<b>1.2</b> Fushatë me materiale të gatshme për mediat .....	7
<b>II.</b>	Përmbledhja Ekzekutive .....	11
<b>III.</b>	Metodologjia .....	13
<b>IV.</b>	Koha mediatike kushtuar çështjeve të aftësisë së kufizuar .....	15
<b>V.</b>	Shkrimet kushtuar Personave me Aftësi të Kufizuara.....	19
<b>VI.</b>	Frekuenca e përdorimit të fjalëve kyçe lidhur me Aftësinë e Kufizuar.....	21
	<b>6.1</b> Fjalët kyçe në raportime në TV .....	21
	<b>6.2</b> Fjalët kyçe në raportimet në median e shkruar dhe atë online.....	23
<b>VII.</b>	Problemet e komunitetit në vëmendjen e medias.....	25
<b>VIII.</b>	Përfundime .....	27
<b>IX.</b>	Rekomandime.....	28
	Referenca .....	29

# Lista e Figurave

<b>Figura 1.</b>	Njoftim për shtyp i PD dt. 22.04.2021 .....	8
<b>Figura 2.</b>	Artikull i Panorama Online dt. 22.04.2021 .....	8
<b>Figura 3.</b>	Njoftimi për shtyp i PS dt. 23.04.2021 .....	9
<b>Figura 4.</b>	Artikulli i Shqiptarja.com 23.04.2021 .....	9
<b>Figura 5.</b>	Lajm i publikuar nga Balkanweb dt.20.04.2021 .....	10
<b>Figura 6.</b>	Grafiku për raportin midis kohës totale dhe kohës kushtuar Aftësisë së Kufizuar .....	15
<b>Figura 7.</b>	Grafiku për kohën televizive që TV i kanë kushtuar Aftësisë së Kufizuar .....	17
<b>Figura 8.</b>	Grafiku për shkrimet ku trajtohen çështje të Aftësisë së Kufizuar .....	19
<b>Figura 9.</b>	Gjuha përfshirëse për Aftësinë e Kufizuar .....	21
<b>Figura 10.</b>	Grafiku për fjalët kyçe në median e shkruar/online.....	23
<b>Figura 11.</b>	Tabela e temave të trajtuara në media .....	25

# Shkurtime

<b>RSH</b>	Republika e Shqipërisë
<b>KDPAK</b>	Konventa për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara
<b>KMCAP</b>	Komisioni Mjekësor i Caktimit të Aftësisë për Punë (KEMP)
<b>PSSH</b>	Partia Socialiste e Shqipërisë
<b>PDSH</b>	Partia Demokratike e Shqipërisë
<b>LSI</b>	Lëvizja Socialiste për Integrim
<b>PAA</b>	Partia Agrare-Ambjentaliste
<b>NTH</b>	Nisma Thurje
<b>OSHC</b>	Organizata të Shoqërisë Civile
<b>OSBE</b>	Organizata për Siguri dhe Bashkëpunim në Europë
<b>ODHIR</b>	Zyra për Institucione Demokratike dhe të Drejtat e Njeriut
<b>TCH</b>	Top Channel
<b>ATSH</b>	Agjencia Telegrafike Shqiptare
<b>RTSH</b>	Radiotelevizioni Publik Shqiptar
<b>ISHM</b>	Instituti Shqiptar i Medias
<b>ALEXA</b>	Alexa, është një teknologji ndihmëse virtuale e zhvilluar nga Amazon
<b>BMM</b>	Bordi i Monitorimit të Medias
<b>KQZ</b>	Komisioni Qendror i Zgjedhjeve
<b>MSHMS</b>	Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale
<b>OBSh</b>	Organizata Botërore e Shëndetësisë

# I. HYRJJE

## 1.1 Roli i medias në pasqyrimin e fushatës elektorale

“Mediumi është mesazhi”<sup>1</sup>, sipas teoricienit të komunikimit Marshall McLuhan. Megjithatë nuk ka dyshim se gjatë zgjedhjeve komunikohen një sërë mesazhesh të ndryshme përmes të njëjtit medium. Debati që shënoi epokën e re televizive të fushatave elektorale ishte ai mes Kenedy-t dhe Nixon, në vitin 1960. Gjashtë dekada më pas, interneti krijoi një qasje tjetër në raportimin e zgjedhjeve, duke i dhënë fund disa praktikave të njohura sikurse heshtja zgjedhore apo periudha e reflektimit. Kjo pasi interneti vepron gjerësisht jashtë një kuadri rregullator për procesin zgjedhor.<sup>2</sup> Në kohët e globalizimit të informacionit vërehet një tendencë në fushata zgjedhore për të përdorur më shumë pamjen sesa përmbajtjen, sloganin më shumë sesa platformën, batutën më shumë sesa premtimin. Në këtë koleksion imazhesh krijohet ajo që Guy Debord e cilëson si “spektakli që nuk përëndon asnjëherë në perandorinë moderne të pasivitetit.”<sup>3</sup> Konsolidimi i kësaj qasje, e shndërron median në busullën orientuese të agjendës politike të partive, madje edhe në vende më pak të zhvilluara në aspektin e teknologjisë së informacionit, sikurse Shqipëria. Sipas Gjykatës Europiane për të Drejtat e Njeriut, ekzistojnë 2 funksione kyçe të medias:

- ◆ Informuese e publikut për alternativat politike
- ◆ Roje vëzhguese e qeverisë dhe institucioneve përgjegjëse për administrimin zgjedhor.

Këto 2 aspekte të funksionit të medias në fushatë zgjedhore nuk përfaqësojnë detyra të posaçme për një stacion televiziv, gazetë apo portal sesa imponojnë detyrimin që pushteti ekzekutiv ka për të garantuar kushtet e përshtatshme që media të mund të kryej këto funksione. Në këtë frymë, qeveritë e çdo vendi sovran hartojnë një kuadër

1. McLuhan Marshall, Instrumentat e komunikimit (Media si një zgjatim i njeriut), 2008.

2. Electoral Knowledge Network, Komuniteti më i madh online për informacionet me karakter zgjedhor i prezantuar në Kombet e Bashkuara në vitin 1998 nga International Foundation for Electoral System.

3. Debord, G., “Shoqëria e Spektaklit”, 2009.

ligjor të posaçëm për të pasur pasqyrim të drejtë, pa asnjë formë diskriminimi dhe transparent të të gjithë procesit zgjedhor, duke përfshirë edhe garën elektorale deri në ditën e votimit. Në Shqipëri nuk ka një ligj të posaçëm që rregullon median e shkruar. Në Kushtetutën e Shqipërisë, neni 22 dhe neni 23 garantojnë respektivisht lirinë e shprehjes, lirinë e shtypit, të radios dhe televizionit si dhe të drejtën për informim. Ndërsa për shtypin nuk ka ligje të posaçme, rregullimi i medias audio-vizive bëhet me anë të Ligjit nr. 97/2013 datë 4.3.2013 për Median Audio-vizive në Republikën e Shqipërisë.<sup>4</sup>

## 1.2 Fushatë me materiale të gatshme për mediat

E drejta që Kodi Zgjedhor i njeht medias në Shqipëri për të përdorur regjistrimet e veprimtarive elektorale të subjekteve zgjedhore, me kushtin për ta shoqëruar materialin filmik me shënimin “i përgatitur nga subjekti...” përdoret gjerësisht prej disa vitesh në fushata zgjedhore. Të ashtuquajturat “kaseta” të dikurshme janë zëvendësuar nga materiale që përcillen elektronikisht me email ose në platforma virtuale si Youtube, Facebook dhe Instagram. Zyrat e Shtypit të tri partive kryesore në vend, PD, PS dhe LSI vinin në dispozicion për mediat gjatë fushatës linkun e *Live Stream*-it në Youtube dhe Facebook pak minuta përpara se të nis aktiviteti. Për rrjedhojë mediat u vendosën përpara faktit detyrues të përdorimit të pamjeve filmike të gatshme për të pasqyruar aktivitetet elektorale të tri partive kryesore, të cilave iu vendosej logo e subjektit politik, në rastin kur ato u përgatitën edhe si kronika për edicionet informative. Kjo logo ishte shënimi i vetëm mbi materialin e gatshëm që mediat kanë vendosur në transmetimet e tyre televizive të ashtuquajtura “të drejtpërdrejta”. Përdorimi i termit “të ashtuquajtur” nënkupton faktin se shpeshherë aktivitetet e “shitura” se po ndodhnin drejtpërdrejtë në momentin që linku vihej në dispozicion nga zyrat për shtyp të selive të partive, në të vërtetë kishin disa kohë që ishin regjistruar dhe publikoheshin sipas një axhende të përcaktuar nga drejtorët e komunikimit në shtabet elektorale të çdo subjekti politik.

Një nga këto raste i verifikuar është nënshkrimi i marrëveshjes mes OSHC-ve që kujdesen për të drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara dhe subjektit politik, Partia Demokratike. Ky aktivitet u zhvillua në 6 Prill 2021, bazuar në ftesën që PD u ka dërguar të gjithë organizatave që përfaqësojnë Personat me Aftësi të Kufizuara për të qenë të pranishme, por u transmetua në 13 Prill. Materiali filmik i kaluar në post-produksion (montazh) kishte një kohëzgjatje prej 22 minuta e 30 sekonda. Ai

---

4. “Shqipëria miratoi një ligj për Shtypin në vitin 1993, ligj i konsideruar gjerësisht si opresiv. (Ligji 7756, dt. 11.10.1993). Pas një beteje disavjeçare, në vitin 1997 me ligjin 8239, Kuvendi shfuqizoi të gjitha nenet e ligjit të mëparshëm me përjashtim të paragrafit të parë të nenit të parë ku shkruhet: “Shtypi është i lirë”

u transmetuar i plotë nga kanalet televizive informative si një aktivitet i drejtpërdrejtë, pa logon e partisë, ndërsa në mbrëmje disa televizione kishin përgatitur një kronikë mesatarisht prej 2 minutash të shoqëruar me logon përkatëse. E njëjta gjë ndodh edhe me një aktivitet të drejtuesit politik të PS në Vlorë, z. Damian Gjijknuri, takimi i të cilit, edhe pse ishte zhvilluar pasditen e 22 prillit, u vu në dispozicion për mediat mesditën e 23 Prillit. Praktika e vendosjes së logos së partive në fotografitë e vëna në dispozicion nga zyrat e shtypit u përdor edhe nga gazetaret dhe portalet. Por ajo çka spikat në mesazhet e përcjella nga këto medime është edhe përdorimi i plotë i tekstit të servitur në formën e lajmit nga zyrat e shtypit të partive. Ngjashmëritë mes njoftimit për shtyp dhe lajmit të publikuar në median e shkruar, të aksesueshme edhe në versionin online, bashkë me portalet informative nxorren në pah në këto zgjedhje përdorimin e gjerë të “Copy&Paste” të tekstit të gatshëm. Për të evidentuar konkretisht këtë tendencë janë përzgjedhur rastësisht dy takime elektorale të dy subjekteve politike (PS dhe PD) 2 ditë para përfundimit të fushatës dhe është parë sesi janë pasqyruar këto takime në portale dhe gazeta në versionin online që konsiderohen me numër të madh shfletuesish referuar renditjes që bën platforma ALEXA<sup>5</sup>, në kushtet kur të dhënat “sistematike dhe të besueshme në lidhje me audiencën, lexueshmërinë dhe popullaritetin e mediave mungojnë për pothuajse të gjitha llojet e mediave në vend, një çështje që ka mbetur e pazgjidhur”<sup>6</sup> në këto 3 dekada.

### Figura 1. Njoftim për shtyp i PD dt. 22.04.2021

- Braktisja vazhdon: teksta Rama flet në miting, mbi 500 socialistë bashkohen me Bashën në Durrës.

- Basha me socialistët në Durrës: Ky nuk është vendi i Edi Ramës, është vendi i shqiptarëve. Të dilen fitorja më e bukur e Shqipërisë.

#### NJOFTIMI PËR TAKIMIN E KRYETARIT TË PD, LULZIM BASHA, ME RRETH 500 SOCIALISTË TË ZHGENJYER NË DURRËS

Kryetari i Partisë Demokratike, Lulzim Basha, ka zhvilluar një takim me rreth 500 socialistë të zhgënjyer që i bashkohen ndryshimit më 25 prill.

Ardit Kërtusha u shpreh se ndihet fajtor që ka bërë fushatë deri më tani për Edi Ramën, pasi ajo që panë nga qeverisja e tij, ishte vetëm një fasadë harrese dhe nëpërkëmbje. Mbështetje për Partinë Demokratike në këto zgjedhje - sipas Kërtushës- vjen nga shpresa për një të ardhme më të mirë, ku për këtë ftoi të gjithë socialistët të votojnë për ndryshimin më 25 prill.

### Figura 2. Artikull i Panorama Online dt. 22.04.2021

**Kryetari i Partisë Demokratike, Lulzim Basha, ka zhvilluar një takim me rreth 500 socialistë të zhgënjyer që i bashkohen ndryshimit më 25 prill.**



Ardit Kërtusha u shpreh se ndihet fajtor që ka bërë fushatë deri më tani për Edi Ramën, pasi ajo që panë nga qeverisja e tij, ishte vetëm një fasadë harrese dhe nëpërkëmbje. Mbështetje për Partinë Demokratike në këto zgjedhje -sipas Kërtushës- vjen nga shpresa për një të ardhme më të mirë, ku për këtë ftoi të gjithë socialistët të votojnë për ndryshimin më 25 prill.

5. <https://www.alex.com/topsites/countries/AL>

6. Peisazhi i Medias Online ne Shqipëri, Kap: Modeli i Biznesit Online”, fq. 36, 2018.



### Figura 3. Njoftimi për shtyp i PS dt. 23.04.2021

Drejtuari politik i Partisë Socialiste për Qarkun e Vlorës Damian Gjinkuri shoqëruar nga kandidatët për deputetë zhvilluan takime elektorale përmbyllëse të fushatës në rajonin Nr.4 dhe Nr.5 të qytetit bregdetar.

Pjesëmarrja masive e qytetarëve në takimin e organizuar në lagjen Çole sipas Gjinkurit është treguesi më i qartë se rezultati i zgjedhjeve të 25 Prillit do të jetë i padiskutueshëm dhe i thellë.

"Shikoni sa shumë jemi këtu sot. Më shumë kemi njerëz këtu në këtë takim në Çole se sa kishte Luizim Basha me gjithë Qarkun në mitingun e Vlorës. Ne e mundim Luizim Bashën edhe vetëm me Çolen sepse Çolja është zemra e Vlorës", u shpreh Gjinkuri.

Sipas tij, ajo çka ndodhi në Vlorë nuk erdhi rastësisht por sepse në pushtet kemi Partinë Socialiste e cila e ka vërtetuar se e do Vlorën. "Alternativat e tjera nuk na çojnë askund. Është e faktuar se Partia Demokratike kur është në pushtet nuk mendon fare për Vlorën por veprat e punët e nisura i lë si zgavra të hapura. Projektet e nisura në lagjet "Çole" e "Kume" të rajonit 4 duhet të vijojnë ndërsa i garantoj banorët se shumë projekte të tjera na presin. Të votosh për Partinë Socialiste këtë herë do të thotë të votosh për Vlorën. Partia Socialiste ndryshe nga partitë e tjera e kanë dhënë garancinë se janë të vetmit që punojnë për ju", theksoi Gjinkuri.

### Figura 4. Artikulli i Shqipëtarja.com 23.04.2021

Drejtuari politik i Partisë Socialiste për Qarkun e Vlorës Damian Gjinkuri shoqëruar nga kandidatët për deputetë zhvilluan takime elektorale përmbyllëse të fushatës në rajonin Nr.4 dhe Nr.5 të qytetit bregdetar.

Pjesëmarrja masive e qytetarëve në takimin e organizuar në lagjen Çole sipas Gjinkurit është treguesi më i qartë se rezultati i zgjedhjeve të 25 Prillit do të jetë i padiskutueshëm dhe i thellë.



[Sh]  
.COM

LEJO EDHE:  
Ish-ministria e Arsimit Besa Shahini: Do të shkoj në Tiranë për të votuar PS, vazhdon të jetë opsioni më i mirë për Shqipërinë

"Shikoni sa shumë jemi këtu sot. Më shumë kemi njerëz këtu në këtë takim në Çole se sa kishte Luizim Basha me gjithë Qarkun në mitingun e Vlorës. Ne e mundim Luizim Bashën edhe vetëm me Çolen sepse Çolja është zemra e Vlorës", u shpreh Gjinkuri.

Sipas tij, ajo çka ndodhi në Vlorë nuk erdhi rastësisht por sepse në pushtet kemi Partinë Socialiste e cila e ka vërtetuar se e do Vlorën.

"Alternativat e tjera nuk na çojnë askund. Është e faktuar se Partia Demokratike kur është në pushtet nuk mendon fare për Vlorën por veprat e punët e nisura i lë si zgavra të hapura. Projektet e nisura në lagjet "Çole" e "Kume" të rajonit 4 duhet të vijojnë ndërsa i garantoj

Praktika e mbulimit të aktiviteteve elektorale si lajme me një burim të vetëm informacioni është një nga shqetësimet kryesore që vërehen edhe në studimin "Peisazhi i Medias Online në Shqipëri" i realizuar nga Instituti Shqiptar i Medias me mbështetjen e Fondacionit Shoqëria e Hapur për Shqipërinë.

Në këtë hulumtim të parin në llojin e tij për median online në vendin tonë, të zhvilluar në vitin 2018-të, rezultoi si problematikë edhe mungesa e saktësisë së lajmit, duke iu referuar publikimit të deklaratave të plota të politikanëve në llogaritë e tyre persona në rrjetet sociale. "Është shumë e vështirë të gjesh një artikull që jo vetëm tregon atë që tashmë është botuar në media sociale, por edhe merr mundimin të verifikojë deklaratën ose të sfidojë vërtetësinë e informacionit ose të pohimeve të bëra."<sup>7</sup> Një dukuri e tillë ka spikatur gjerësisht edhe në këtë fushatë elektorale sikurse vërehet në Figurën 5.

7. Peisazhi i Medias Online në Shqipëri, Kap: Saktësia dhe Verifikimi i Informacionit një praktikë në zhdukje", ISHM, fq. 20, 2018, [https://www.osfa.al/sites/default/files/peizash\\_i\\_medias\\_online.pdf](https://www.osfa.al/sites/default/files/peizash_i_medias_online.pdf)

**Figura 5.** Lajm i publikuar nga Balkanweb dt.20.04.2021

Kryetarja e kësaj partie, Monika Kryemadhi, nëpërmjet një postimi në “Facebook”, ka publikuar një kolazh fotosh, me momente nga takimi.

Kryemadhi e cilëson takimin si madhështorë, e shton se LSI është në një moment final për të arritur një fitore të madhe më 25 prill, me qëllim plotësimin e kauzave të tyre.

### **Postimi i plotë i Monika Kryemadhit:**

Dëshira e qytetarëve për ndryshim është më fortë se kurrë. Entuziazmi në njësinë nr. 5 në Tiranë, tregon se kemi të bëjmë me një përmbysje të madhe që nuk e ndal dot askush.

Rastet e evidentuara dëshmojnë qartazi se raportimi i fushatës nga mediat në Shqipëri u orientua kryesisht nga materialet e gatshme të përgatitura nga vetë partitë kryesore politike PD, PS dhe LSI që kanë pasur edhe mundësinë financiare për të siguruar mbështetje teknike të nevojshme në përgatitjen e këtyre materialeve. Kjo ka kufizuar ndjeshëm mediat në përgjithësi në raportime të mirëfillta gazetareske për të vendosur fokusin e tyre në përrputhje me interesin e publikut ndaj programeve elektorale dhe për të evidentuar dhe matur shkallën e mundësisë për realizimin e premtimeve që partitë ofronin për disa kategori sociale, mes tyre dhe për Personat me Aftësi të Kufizuara. Disa stacione televizive ia dolën të realizojnë kronika apo intervista që i japin zë shqetësimeve të kategorive të disavantazuara në këtë fushatë, por ato mbetën sporadike. Fare pak hapësirë ka pasur në debatet politike të mbrëmjes për shqetësimet që kanë kategori të caktuara sociale dhe premtimet që partitë politike u adresojnë atyre, për të përmirësuar gjendjen social-ekonomike në cilën ata/ato ndodhen.

## II. PËRMBLEDHJA EKZEKUTIVE

Media është një instrument kyç për komunikimin politik mes partive dhe zgjedhësve, por në veçanti gjatë fushatës rëndësia e raportimit është thelbësore për votuesit në zbërthimin e alternativave politike që u parashtrohen përpara ditës së zgjedhjeve. Në këtë kuadër ky raport monitorues ka për qëllim të nxjerr në pah sesa vëmendje i ka kushtuar media raportimit të çështjeve të Aftësisë së Kufizuar nga 5 Shkurti deri në 25 Prill 2021, jo vetëm në aspektin e minutazhit por edhe në drejtim të cilësisë së raportimit për ato probleme që lidhen drejtpërdrejtë me këtë komunitet. Monitorimi i mediave është përqëndruar tek shkrimet, kronikat televizive, intervistat apo debatet ku dalin në pah çështje të Personave me Aftësi të Kufizuara, të drejtat e tyre për pjesëmarrje në jetën politike dhe ekonomike të vendit. Mbledhja e informacionit u realizua përmes 5 indikatorëve të matshëm të përcaktuar si më poshtë:

- ◆ Koha kushtuar trajtimit të problemeve që kanë Personat me Aftësi të Kufizuara në programet e partive politike.
- ◆ Koha mediatike që iu kushtohet përfaqësuesve politike për trajtimin e çështjeve që lidhen me Aftësinë e Kufizuar.
- ◆ Frekuenca e Përdorimit të fjalëve kyçe që lidhen me çështjet e Aftësisë së Kufizuar.
- ◆ Numri i raportimeve që në media raportohet për Personat me Aftësi të Kufizuara.
- ◆ Numri i shkrimeve që trajtohen çështjet e Personave me Aftësi të Kufizuar

Nga vëzhgimi që i është bërë medias elektronike, përkatësisht RTSH, Top Channel, News24, Euronews Albania, ABC, Report TV për fashën kohore me shikueshmëri më të lartë, (18:00-24:00) rezulton se më pak se 1% e kohës televizive i është kushtuar Personave me Aftësi të Kufizuara. Përpos raportimit të aktiviteteve elektorale me materiale të gatshme të ofruara nga vetë partitë për transmetim që dominuan pjesën më të madhe të kohës televizive kushtuar këtij grupimi social, ka pasur edhe tematika të trajtuara nga gazetarët në edicione informative dhe studio televizive. Çështja më e trajtuar gjatë periudhës së monitorimit ka qenë protesta që një grup Personash me Aftësi

të Kufizuara bënë fillimisht në Korçë e Pogradec dhe më pas në Tiranë, për të kërkuar rimbursimin që shteti u detyrohet për pagesën e kujdestarisë për vitet 2010-2011. Kjo çështje u mediatizua më shumë kur protesta u zhvendos në Tiranë përpara MSHMS. RTSH, TCH dhe Euronews i kushtuan kronika në edicionet e tyre si dhe TCH i kushtoi dhe një kohë televizive më të madhe në emisionin e mëngjesit. Gjithashtu temat të tjera të trajtuara kanë qenë edhe përfshirja e Personave me Aftësi të Kufizuara në një plan të posaçëm vaksinimi, aksesit i tyre në qendrat e votimit dhe përfshirja në programet e partive politike me premtime të dedikuara për ta. I vetmi kandidat që i përkiste kësaj kategorie iu dha 1 minutë e 25 sekonda kohë televizive për t'u prezantuar në një emision të TCH. Në raport me televizionin, shtypi i shkruar dhe media online kanë qenë më të vakëta në shkrimet kushtuar çështjeve të Aftësisë së Kufizuar. Gjatë periudhës së vëzhgimit të Panorama, Koha Jonë, Balkanweb, Shqiptarja.com, ATSH (Agjencia Telegrafike Shqiptare) janë evidentuar vetëm 12 shkrime që kanë në fokus Personat me Aftësi të Kufizuara. Të dymbëdhjetë shkrimet janë aktivitete elektorale të partive të mbështetura ekskluzivisht në njoftimet për shtyp të përgatitura nga vetë subjektet politike dhe në postimet në rrjete sociale që kanë bërë kandidatët dhe kandidatet për deputetë. Praktika e mbulimit të aktiviteteve elektorale si lajme me një burim të vetëm informacioni është një nga shqetësimet e hershme për cilësinë e raportimit në mediat shqiptare që dominoi ndjeshëm edhe në këtë fushatë.

### III. METODOLOGJIA

Për të gjykuar dhe vlerësuar pasqyrimin në media të fushatës elektorale, me fokus të veçantë trajtimin e çështjeve që lidhen me Personat me Aftësi të Kufizuara, metodologjia e punës kërkimore konsiston në vlerësimin e pasqyrimin në sasi dhe cilësi të çështjeve që lidhen me këtë kategori sociale, në përputhje me nivelin e përfshirjes së tyre në programet elektorale të partive politike PS, PD, LSI dhe Nisma Thurje. Për të pasur një tablo të plotë në lidhje me aksesin që u është dhënë në media Personave me Aftësi të Kufizuara gjatë mbulimit të fushatës elektorale për zgjedhjet e 25 Prillit, analiza u përqëndrua në vëzhgimin e raportimeve në median elektronike si dhe në median e shkruar që ka tirazhin më të madh të kopjeve të shitura, njëherësh dhe numrin më të madh të shfletimeve në versionin online, si dhe portalet kryesore më të klikuara.

Në Shqipëri mungojnë të dhëna zyrtare të sakta në lidhje me shfletimet, por për këtë është përdorur platforma e Amazon, Alexa si burim referimi për të përcaktuar mediat që do t'i nënshtroheshin këtij vëzhgimi.

Sa i takon stacioneve televizive, duhet theksuar se me procesin e digjitalizimit, pra kalimin e sinjalit nga analog në digjital, mediat tashmë janë në një konkurrencë të hapur sa i takon shikueshmërisë, e cila nuk kufizohet më nga licenca, duke qenë se të gjitha televizionet, kombëtare apo lokale, mund të ndiqen në platformat digjitale. Më konkretisht mbulimi i fushatës elektorale nga media u monitorua në stacionet televizive të mëposhtme:

- ◆ RTSH
- ◆ Top Channel
- ◆ News24
- ◆ Euronews Albania
- ◆ ABC
- ◆ Report TV

Ndërsa për median e shkruar dhe atë online u monitoruan:

- ◆ Panorama
- ◆ Koha Jonë
- ◆ Balkanweb
- ◆ Shqiptarja.com
- ◆ ATSH (Agjencia Telegrafike Shqiptare)

Monitorimi i tyre nuk ka patur si objektiv të tij vlerësimin e respektimit të kërkesave të Kodit Zgjedhor për ndarjen e kohës televizive midis subjekteve zgjedhore, partive politike, përdorimin e reklamave për fushatën zgjedhore, apo kufizimeve në lidhje me pasqyrimin në media të aktiviteteve të institucioneve. Përzgjedhja e kohës është bërë në përputhje me brezin kohor të edicioneve informative dhe emisioneve të aktualitetit politik, por edhe programeve të tjera televizive që sjellin në vëmendje çështje të Aftësisë së Kufizuar gjatë fushatës elektorale. Monitorimi i mediave është përqëndruar tek shkrimet, kronikat televizive, intervistat apo debatet ku dalin në pah çështje të Personave me Aftësi të Kufizuara, të drejtat e tyre për pjesëmarrje në jetën politike dhe ekonomike të vendit. Mbledhja e informacionit u realizua përmes 5 indikatorëve të matshëm të përcaktuar si më poshtë:


- ◆ Koha kushtuar trajtimit të problemeve që kanë Personat me Aftësi të Kufizuara në programet e partive politike.
- ◆ Koha mediatike që iu kushtohet përfaqësuesve politike për trajtimin e çështjeve që lidhen me Aftësinë e Kufizuar.
- ◆ Frekuenca e Përdorimit të fjalëve kyçe që lidhen me çështjet e Aftësisë së Kufizuar.
- ◆ Numri i raportimeve që në media raportohet për Personat me Aftësi të Kufizuara.
- ◆ Numri i shkrimeve që trajtohen çështjet e Personave me Aftësi të Kufizuara.

Indikatorët e mëposhtëm do të përkthehen në evidentimin e kohës që mediat i kanë kushtuar çështjeve të Aftësisë së Kufizuar gjatë fushatës krahasimisht me të tjera tematika dhe kategori sociale.

## IV. KOHA MEDIATIKE KUSHTUAR ÇËSHTJEVE TË AFTËSISË SË KUFIZUAR

**Figura 6.** Grafiku për raportin midis kohës totale dhe kohës kushtuar Aftësisë së Kufizuar

### MONITORIMI I MEDIAS ELEKTRONIKE (TV) 5 SHKURT - 25 PRILL (ORË)



Periudha e monitorimit të medias është shtrirë përgjatë 2 muajsh e 20 ditësh, në të cilën është monitoruar kryesisht fasha orare 18:00 deri në 24:00, që konsiderohet për stacionet televizive si me shikueshmëri më të lartë. Gjatë këtij gjashtë-orarëshi janë mbajtur në vëzhgim, jo vetëm edicionet kryesore të lajmeve dhe transmetimet direkte, por njëherësh edhe emisionet e aktualitetit politik. E përkthyer në kohë totale televizive, për 2 muaj e 20 ditë, përlogarit të jenë 480 orë me shikueshmëri të lartë, në dispozicion të partive politike në garë për zgjedhjet e 25 Prillit. Nga këto 480 orë, gjatë monitorimit janë evidentuar vetëm 2 orë, pra më pak se 1 % e totalit të kohës televizive të pasdites së vonë (Prime Time), i është kushtuar vecanërisht çështjeve të Personave me Aftësi të Kufizuara. Ky raport dukshëm i shpërpjestuar tregon sesa në vëmendje të medias kanë qenë në këto zgjedhje çështjet e Personave me Aftësi të Kufizuara.

Në krye të kësaj renditje me numrin më të madh të materialeve të transmetuara kushtuar Personave me Aftësi të Kufizuara qëndron News24, një stacion informativ që ka transmetuar takimet e plota të pjesës më të madhe të aktiviteteve të zhvilluara nga partitë kryesore PD, PS dhe LSI. Përmes togfjalëshit “pjesa më e madhe” nënkuptohet përzgjedhja që iu është bërë për transmetim takimeve elektorale bruto (të plota) pas datës 25 Mars, me fillimin zyrtar të fushatës, kur Bordi i Monitorimit të Medias (BMM), i ngritur nga KQZ, nisi punën mbikqyrëse për të ruajtur balancën e kohës televizive për partitë politike në përputhje me kriteret e përcaktuara në Kodin Zgjedhor. Ky vëzhgim nga BMM solli dhe një lloj reduktimi të numrit të aktiviteteve të transmetuara të plota, për shkak se ato zënë dhe pjesën më të madhe të kohës televizive, krahasimisht me një kronikë që ka një standard prej 1 minutë e 30 sekonda deri në maksimumi 2 minuta, brenda një edicioni informativ. Aktivitetet e plota në çdo rast ishin të aksesueshme në platformat online si Youtube dhe Facebook, të cilat ishin një instrument i fortë në marketingun politik të partive në këto zgjedhje, sa kohë që mbetën jashtë kuadrit rregullator të ligjit dhe optikës së BMM.


Referuar monitorimit të bërë posaçërisht për këtë raport kërkimor rezultoi se televizioni News24 ka transmetuar në total 8 takime elektorale ku përmenden çështje të Aftësisë së Kufizuar ose takohen Persona me Aftësi të Kufizuara. Shtatë aktivitete i përkasin Partisë Demokratike ndërsa një aktivitet është i Këshillit të Ministrave me temë “Revolucioni Digjital i Platformës E-Albania”, në të cilin kryeministri jep një përgjigje 25 sekondëshe pyetjes së një prej gazetarëve për përshtatjen e platformës në fjalë për personat që nuk shikojnë. Ky sinkron i vogël nuk gjeti pasqyrim në kronikat e mëvonshme të përgatitur për këtë dalje publike të kryeministrit. Vlen të theksohet se 7 nga 8 aktivitete janë materiale të gatshme të servitura nga PD, ndërsa konferenca me gazetarët e kreut të qeverisë është zhvilluar online në kushtet e pandemisë së Covid-19. Vetëm një nga këto 8 takime të transmetuara bruto rezultoi të ishte përgatitur më pas edhe si kronike për edicionin informativ të mbrëmjes ku është lënë në sinkron edhe premtimi i liderit të PD për Personat me Aftësi të Kufizuar, ndërsa 7 të tjerat janë transmetuar vetëm bruto, pa u përfshirë në edicion. News24 ka transmetuar aktivitete elektorale ku përmenden dhe shfaqen Persona me Aftësi të Kufizuara, në një total prej 40 minutash e 49 sekonda kohë televizive. Aktiviteti me kohëzgjatjen më të madhe është marrëveshja e PD me shoqatat që kujdesen për të drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara, plot 22 minuta e 29 sekonda. Por ky TV nuk rezulton të ketë pasur në vëmendje, gjatë periudhës së monitorimit, kronika apo emisione të përgatitura nga gazetarët e tij, posaçërisht për përfshirjen në jetën politike dhe ekonomike të vendit të këtij grupimi social.

Në vendin e dytë për numër materialesh të transmetuara, renditet Top Channel. Stacioni televiziv i formatit gjeneralist i ka kushtuar çështjeve të aftësisë së kufizuar 5 materiale, mes të cilave 2 emisione dhe 3 kronika në edicionin informativ qendror të mbrëmjes. Një prej emisioneve është Wake Up, ku në puntatën e datës 26 Mars 2021 është trajtuar çështja e pagesave të prapambetura të kujdestarisë për Personat me Aftësi të Kufizuara. Në studio për këtë temë ishte ftuar përfaqësuesi ligjor i një grupi personash që nuk shikojnë z. Sinan Tafaj, i cili parashtroi pretendimet e kësaj kategorie për të përfituar nga pagesat e prapambetura. Biseda prej 18 minuta e 40 sekonda në lidhje me këtë temë është më e gjata në një studio televizive që është evidentuar gjatë fushatës, në të cilën i është lënë hapësirë shqetësimeve që kanë Personat me Aftësi të Kufizuara. Emisioni i dytë ku është folur për Aftësinë e Kufizuar është Top Story. Emisioni Investigativ në puntatën e datës 20 Prill 2021 ka prezantuar kandidatët e rinj të forcave të ndryshme politike, mes tyre edhe Daniel Çokun, kandidatin e pozicionuar i dyti në listat e Nismës Thurje (NTH) në qarkun e Lezhës. Koha e dedikuar për këtë kandidat është 1 minutë e 25 sekonda. Ky ka qenë prezantimi i vetëm në një emision të një kanali televiziv kryesor, në prime time, që i është bërë të vetmit kandidati i cili i përket komunitetit të Personave me Aftësi të Kufizuara dhe kërkon publikisht t'i përfaqësojë ata/ato në Kuvend. Tre materialet e tjera janë kronika brenda një edicioni informativ. Dy



prej tyre pasqyrojnë aktivitete politike të Partisë Demokratike, përkatësisht prezantimin e programit për mirëqenien sociale në 8 Shkurt 2021 dhe nënshkrimin e marrëveshjes me shoqatat që kujdesen për të drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara në 13 Prill 2021. Ndërsa kronika e tretë i kushtohet thirrjes që ky komunitet i drejton në 10 Prill autoriteteve për t'i përfshirë në planin e vaksinimit si një nga kategoritë e rrezikuara nga Covid-19, sipas OBSH. Në total TCH i ka kushtuar 23 minuta e 54 sekonda kohë televizive çështjeve të Aftësisë së Kufizuar gjatë periudhës së monitorimit.

**Figura 7.** Grafiku për kohën televizive që TV i kanë kushtuar Aftësisë së Kufizuar



**RTSH** rezulton të t'i ketë kushtuar çështjeve të Aftësisë së Kufizuar, gjatë periudhës së monitoruar, 13 minuta e 32 sekonda kohë televizive. Në këtë minutazh përfshihen 3 kronika të transmetuara në edicionin qendror informativ për të drejtën e Personave me Aftësi të Kufizuara për të votuar. Në të parën ka qenë drejtuesja ekzekutive e Fondacionit "Së Bashku", znj. Suela Lala, e cila ka dhënë një intervistë për gazetaren e RadioTelevizionit Publik Shqiptar më 2 Prill, në Ditën Ndërkombëtare të Sindromës së Spektrit Autik. Fokusi ka qenë monitorimi i përgatitjeve të KQZ në lidhje me aksesin e votuesve me Aftësi të Kufizuara në ditën e votimit. Ndërsa në kronikën e dytë, evidentohen përmes një vëzhgimi gazetaresk disa QV në Shkodër, të cilat janë vendosur në katet e dyta dhe janë të paaksesueshme për Personat me Aftësi të Kufizuara. Kronika nr. 3 i takon sërish protestës së Personave me Aftësi të Kufizuara për pagat e prapambetura para Bashkisë së Korçës në 5 Mars. Disa ditë më vonë kjo protestë u zhvendos edhe në Tiranë, para MSHMS. Në minutazhin e kohës televizive që RTSH i ka kushtuar këtij komuniteti është edhe një pjesë emisionit nga debati politik i mbrëmjes

në RTSH 24, “Dekalog” nga Roland Qafoku në puntatën e 22 Marsit. Në studio, kandidatja për deputete e PD, Albana Vokshi i është përgjigjur për gati 7 minuta pyetjes së gazetares për programin që PD ka në lidhje me Personat me Aftësi të Kufizuara.

**Euronews Albania** ka transmetuar 3 materiale gjatë periudhës së monitorimit kushtuar çështjeve të aftësisë së kufizuar. Tri materialet janë të përgatitura nga gazetarët e saj. Përkatësisht bëhet fjalë për dy kronika të transmetuara brenda edicionit informativ të datës 24 dhe 29 Mars 2021. Në të parën pasqyrohet protesta e Personave me Aftësi të Kufizuara që kërkojnë pagesat e prapambetura nga Ministria e Shëndetsisë dhe Mbrojtjes Sociale. Ndërsa në kronikën e dytë përcillen shqetësimet e tetra-plegjikëve të cilët ndihen të papërfaqësuar pasi asnjë parti politike nuk ka një program konkret për komunitetin e tyre. Shqetësimet u ngritën nga kryetari i shoqatës së tetra-plegjikëve, z. Saimir Beqiri. Materiali i tretë i transmetuar është një intervistë në studion e këtij televizioni ku në 26 Mars 2021 ka qenë e ftuar znj. Suela Lala, përfaqësuese e Fondacionit “Së bashku” e cila ka ngritur disa shqetësime sa i takon garantimit të aksesit të Personave me Aftësi të Kufizuara në Qendrat e Votimit. Në total, Euronews Albania i ka kushtuar 16 minuta e 26 sekonda çështjeve të Aftësisë së Kufizuara gjatë periudhës së monitorimit prej 2 muaj e 20 ditësh.

Gjatë këtij harku kohor televizioni **ABC** ka transmetuar dy materiale që trajtojnë çështje të Aftësisë së Kufizuar. Një intervistë të znj. Suela Lala, në 1 Mars 2021 në Ditën Ndërkombëtare kundër Diskriminimit ku flitet për të drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara si dhe për monitorimin që Fondacioni “Së Bashku” do t’i bëjë aksesit të tyre në procesin zgjedhor. Ndërsa e dyta është një deklaratë e plotë e kandidatës për deputete e PD në Tiranë, znj. Albana Vokshi mbi humbjen e jetës së një Personi me Aftësi të Kufizuara, i cili nuk merrte shërbime nga institucionet përgjegjëse. Në total ABC i ka kushtuar çështjeve të Aftësisë së Kufizuar gjatë periudhës së monitorimit, 6 minuta e 50 sekonda.


Në monitorim janë evidentuar edhe raste kur aktivitete të partive kushtuar Aftësisë së Kufizuar nuk janë transmetuar në TV gjatë fushatës, por janë publikuar vetëm në Youtube dhe rrjetet e tjera sociale. Kjo ndodhi veçanërisht për kandidatët për deputetë, pasi epërsi në kohën televizive kanë pasur ato aktivitete ku kanë qenë të pranishëm kryetarët e tri forcave kryesore politike të vendit: PS, PD dhe LSI. Gjithashtu ka pasur edhe raste kur në takimet që liderët politikë kanë zhvilluar me përfaqësues të komunitetit të Personave me Aftësi të Kufizuara, sinkronet e vendosura në kronikën televizive të edicionit qendror informativ, nuk përmbanin deklaratat e bëra në lidhje me çështjet e Aftësisë së Kufizuar, por sillnin në vëmendje tematika të tjera të trajtuara në takim. Një rast i tillë është evidentuar tek TV kombëtar **Vizion Plus** në edicionin e datës 15 Prill 2021, në kronikën prej 1 minutë e 30 sekonda nuk përmendet asnjë premtim që kryedemokrati z. Lulzim Basha u bëri dy familjeve që takoi në Kamëz për angazhimet politike që PD do të marrë në përgjigje të nevojave që kanë Personat me Aftësi të Kufizuara.

## V. SHKRIMET KUSHTUAR PERSONAVE ME AFTËSI TË KUFIZUARA

Nëse media elektronike rezulton se i ka kushtuar gati 1 % të kohës televizive çështjeve të Aftësisë së Kufizuar, mund të thuhet se raportimi për këtë temë ka qenë më i vakët në median e shkruar dhe atë online. Në total janë mundur të identifikohen 12 shkrime. Të gjitha janë raportime të aktiviteteve elektorale gjatë fushatës, kryesisht të pasqyruara mbi bazën e materialeve të gatshme të përgatitura nga Zyrat e Shtypit pranë partive ose të shkëputura nga postimet në rrjetet sociale të kandidatëve dhe kandidateve për deputetë.

**Figura 8.** Grafiku për shkrimet ku trajtohen çështje të Aftësisë së Kufizuar

### NUMRI I SHKRIMEVE KUSHTUAR PERSONAVE ME AFTËSI TË KUFIZUAR



Në krye të renditjes për numër artikujsh është Balkanweb, i cili rezulton të ketë publikuar 6 shkrime kushtuar çështjeve të Aftësisë së Kufizuar. Pesë prej tyre janë takime elektorale të kandidatëve të PD, forca kryesore opozitare me një axhendë elektorale aktive kundrejt këtij komuniteti. Ndërsa shkrimi i gjashtë i publikuar në këtë portal i takon deklaratës së PAA-së, lideri i të cilës z. Agron Duka i është bashkuar thirrjes së Personave me Aftësi të Kufizuara për t'u vaksinuar. Ai e quan këtë si "detyrim human dhe ligjor që qeveria ka ndaj këtij komuniteti". Gazeta "Panorama" ka publikuar 2 shkrime kushtuar çështjeve të Aftësisë së Kufizuar. Bëhet fjalë konkretisht për takimin e një kandidateje për deputet të PD në Kavajë me një Person me Aftësi të Kufizura dhe nënshkrimin e marrëveshjes së kreut të Partisë Demokratike, z. Lulzim Basha me organizatat që kujdesen për të drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara.

Gjatë periudhës së monitorimit rezulton se 2 shkrime për çështjet të Aftësisë së Kufizuar ka publikuar edhe "Shqiptarja.com". Portali i ka dhënë zë dy takimeve të kryetarit të PD, z. Lulzim Basha me gratë në njësinë 3 në Tiranë, ku merrte pjesë dhe një grua invalide. Nisur nga pyetja e saj, lideri i PD prezanton programin e kësaj force politike për komunitetin e Personave me Aftësi të Kufizuara. Takimi i dytë i pasqyruar është sërish i kryedemokratit z. Basha me dy familje në Kamëz që kanë në familjen e tyre Persona me Aftësi të Kufizuara. Sakaq nga një shkrim kushtuar kësaj teme rezulton të

kenë publikuar gazeta “Koha Jonë” dhe Agjencia Telegrafike Shqiptare. E përditshmja “Koha Jonë” i jep zë takimit të kandidatit të LSI në qarkun e Durrësit, z. Shemsi Premçi me komunitetin e Personave me Aftësi të Kufizuara. Shkrimi është i mbështetur në postimin që vetë kandidati për deputet z.Premçi ka bërë në Facebook në lidhje me këtë takim. Ndërsa Agjencia Telegrafike Shqiptare ka paqyruar takimin e sipërpërmedur të kryetarit të PD z. Basha me gratë e njësisë 3 në Tiranë. Vlen të theksohet se në gazetata dhe portalet e marra në vëzhgim gjatë 2 muajve e 20 ditëve deri në ditën e votimit nuk është mundur të identifikohet asnjë analizë e problemeve dhe shqetësimeve që ka ky grupim social në Shqipëri. Përgjithësisht media e shkruar dhe ajo online ka qenë më i vakët në ofrimin e një çasje gazetareske profesionale në lidhje me platformat elektorale të partive në garë për zgjedhjet parlamentare të 25 Prillit.

# VI. FREKUENCA E PËRDORIMIT TË FJALËVE KYÇE LIDHUR ME AFTËSINË E KUFIZUAR

## 6.1 Fjalët kyçe në raportime në TV

Gjuha e përdorur në të folurën publike është kanali i komunikimit midis folësit dhe audiencës. Ajo duhet të përshtatet së pari me vetë folësin dhe atë çka ai përfaqëson në shoqëri si dhe me audiencën të cilës ai/ajo i drejtohet. Në rastin e raportimeve mediatike, gjuha e përdorur gjatë fushatës elektorale është një përgjegjësi e dyfishtë që ndahet mes politikanit që mban fjalime dhe gazetarit që duhet të përgatisë kronikën, specialen apo intervistën në kuadër të pasqyrit të fushatës në medianë të cilën ai punon. Në librin “Stand Up, Speak Out” një publikim i Universitetit të Minesotës në 2011-ën, theksohet se mes disa veçorive që duhet të ketë një fjalim publik, me rëndësi thelbësore është përdorimi i gjuhës gjithëpërfshirëse, në mënyrë që mesazhi të perceptohet pa keqkuptime nga e gjithë audiencia, të cilës folësi i drejtohet<sup>8</sup>. Për kategorinë e Personave me Aftësi të Kufizuara renditen në këtë libër

**Figura 9.** Gjuha përfshirëse për Aftësinë e Kufizuar<sup>9</sup>

Gjuha përjashtuese	Gjuha përfshirëse
Njerëzit handikapatë	Persona me Aftësi të Kufizuara
Njeri i çmendur	Personi me Aftësi të Kufizuara psikiatrike (ose emërtohet diagnozën psikiatrike, p.sh. “personi me skizofreni”)
Person me karrige me rrota	Person i cili përdor karrigen me rrota
Sakat	Person me Aftësi të Kufizuara Fizike
Program për nevoja të veçanta	Program për aksesin e nevojave
Mendërisht i vonuar	Person me Aftësi të Kufizuara Intelektuale

**8.** Stand up, Speak out: The Practice and Ethics of Public Speaking, University of Minnesota Libraries Publishing, 2011, Kap. 13.2 Using Language Effectively

**9.** Stand up, Speak out: The Practice and Ethics of Public Speaking, University of Minnesota Libraries Publishing, 2011, Kap. 13.2 Using Language Effectively

edhe disa terma të cilët reflektojnë gjithëpërfshirje kundrejt atyre që reflektojnë përjashtim. Tabela e mëposhtme jep shembuj konkret të terminologjisë gjuhësore përfshirëse, e cila u përdor edhe si udhërrëfyes në identifikimin e fjalëve kyçe të përdorura gjatë raportimeve mediatike në lidhje me çështjet e aftësisë së kufizuar.

Në raportimet mediatike gjatë edicioneve informative të lajmeve, transmetimeve direkte dhe në emisionet kushtuar çështjeve të Aftësisë së Kufizuar në RTSH, News24, TCH, ABC, Euronews dhe Report TV ka nxjerrë në pah një frekuencë të lartë përdorimi të fjalës kyçe “Persona me Aftësi të Kufizuara” e identifikuar 95 herë, e cila përfshihet edhe me gjuhën gjithëpërfshirëse. Në vendin e dytë si termi më i përdorur është “KEMP” me 20 herë dhe në vendin e tretë rezulton të jetë termi “invalid” i përdorur 18 herë. Togfjalëshi “Persona me Aftësi të Kufizuara” është përdorur jo vetëm nga politikanët, por edhe nga përfaqësuesit e organizatave që kujdesen për të drejtat e këtij grupimi social në daljet e tyre publike në media, ndërsa “KEMP” është artikulluar më shpesh nga kandidatët për deputetë për shkak të premtimeve që i kanë bërë individëve të caktuar për përfshirjen e tyre në këtë sistem asistence sociale. “Invalid” është po ashtu një term gjerësisht i përdorur në artikullimin publik të transmetuar në media. Me këtë term nuk iu referohet vetëm atyre që kanë aftësi të kufizuara fizike, por edhe personave që vuajnë nga sëmundje kronike të shkaktuar nga puna që kanë kryer. Në takimet elektorale të kandidatëve që kanë gjetur pasqyrim në median elektronike janë përmendur me një frekuencë më të ulët edhe togfjalësha si “para-plegjikë”; “qytetarë me pamundësi dëgjimi dhe shikimi” dhe “të verbër”, ndërsa “persona me aftësi ndryshe” është një togfjalësh që është përdorur 9 herë, kryesisht nga raportimet e gazetarëve në terren për këtë grupim social. Vlen për t’u theksuar se në përgjithësi ato raportime mbi çështje të aftësisë së kufizuar të evidentuara gjatë monitorimit të medias janë karakterizuar nga një gjuhë gjithëpërfshirëse. Megjithatë media do të duhej të kishte treguar kujdes në ato raste kur drejtues politik kanë përdorur terma si “të verbër” apo “qorr” për të sulmuar kundërshtarin, duke neglizhuar ndjesitë që shkaktojnë tek Personat me Aftësi të Kufizuara për shkak të kësaj gjuhe të ashpër verbale. Kjo ka ndodhur më konkretisht në takimin elektorale të 18 Marsit në Shkodër, kryeministri Edi Rama e ka cilësuar kryetaren e djathtë të Bashkisë së qytetit si “mur qorr dhe shurdh”.<sup>10</sup> Po kaq kujdes pritej edhe për mbulimin e fytyrave të të miturve me aftësi të kufizuara, edhe pse ata/ato janë identifikuar me pamje dhe emër/mbiemër nga politikanët gjatë takimeve elektorale. Shmangia e këtyre dukurive joetike gjatë transmetimit në media të takimeve elektorale ka qenë e mundur veçanërisht në ato raste kur

---


10. <https://www.oranews.tv/mur-qorr-rama-akuza-ademit-pakenaqesia-e-njerezve-ndaj-meje-per-shkak-te-qeverisjes-vendore/>

materialet kanë qenë të regjistruara dhe të ofruara sikur të ishin drejtpërdrejta nga zyrat e shtypit të partive politike.

## 6.2 Fjalët kyçe në raportimet në median e shkruar dhe atë online

Diferenca me gjuhën e përdorur në raportimet e medias së shkruar dhe atë online kundrejt medias elektronike (TV) është kryesisht në frekuencën e përdorimit të termave të caktuar që lidhen me Aftësinë e Kufizuar, jo për shkak të ndryshimit të leksikut të përdorur nga gazetarët, por për shkak të një numri më të vogël materialesh të publikuara në këto medime. Konkretisht gjatë monitorimit janë evidentuar vetëm 12 shkrime në 5 gazeta dhe portale Panorama, Koha Jonë, Balkanweb, Shqiptarja.com, ATSH (Agjencia Telegrafike Shqiptare). Në këto shkrime vërehet një frekuencë e lartë e përdorimit të termit “invalid” me 18 herë, ndërsa “Persona me Aftësi të Kufizuara” është përdorur vetëm 10 herë. Në vendin e tretë për numër përdorimi pozicionohet termi “KEMP” i cili është përdorur 8 herë. Megjithëse shkrimet e publikuara reflektojnë kryesisht të njëjtat aktivitete që janë përcjellë në pjesën më të madhe në median elektronike, diferenca në frekuencën e përdorimit të termave të caktuara lidhet me reduktimin që i bëhet tekstit të ofruar nga partitë.

**Figura 10.** Grafiku për fjalët kyçe në median e shkruar/online



Faktorët e sipërpërmendur kanë ndikuar tërthortazi në ndryshimin e frekuencës së përdorimit të fjalëve kyçe lidhur me Aftësinë e Kufizuar. Një tjetër arsye mund të qëndrojë edhe pas familjaritetit të krijuar në zhargonin popullor me termin “invalid”. Nëse do t’i referohemi etimologjisë, do të kuptojmë sesa e vjetër është kjo fjalë me origjinë nga

latinishtja. Për herë të parë “invalid” është huazuar në fjalorin e gjuhës angleze në vitet 1600. Kjo fjalë qindra-vjeçare është përdorur për t’iu referuar një gjendje të përkohshme pamundësie si rrjedhojë e një lëndimi fizik apo kufizimi<sup>11</sup>. Edhe pse termi konsiderohet i vjetëruar dhe me ngjyresa joetike, “invalid” sërish duket se mbetet shumë familjar për audiencën. Megjithatë, në tituj të shkrimeve që janë evidentuar gjatë monitorimit bie në sy se janë përdorur kryesisht deklarata të shkëputura nga kandidatet dhe kandidatet për deputetë, të cilët i referohen kësaj kategorie me termin që përdoret në KDPAK:

- ◆ “Basha, vizitë dy familjeve në Kamëz: Do dyfishojmë mbështetjen për Personat me Aftësi të Kufizuara” - SHQIPTARJA.COM;
- ◆ “Shemsi Premçi: Do jem zëri i Personave me Aftësi të Kufizuara në Parlament” – KOHA JONË ;
- ◆ “Basha nënshkruan marrëveshjen: Pjesëmarrja e Personave me Aftësi të Kufizuara në vendimmarrje, standard evropian” – PANORAMA.

---

11. Collins Dictionary - <https://collinsdictionary.com/dictionary/english/invalid>



## VII. PROBLEMET E KOMUNITETIT NË VËMENDJEN E MEDIAS

Për të evidentuar problemet e komunitetit të Personave me Aftësi të Kufizuara janë përdorur vetëm ato materiale që janë trajtuar si tema nga gazetarët e mediave elektronike dhe takimet e gatshme të ofruara nga partitë politike gjatë fushatës. Çështja më e trajtuar gjatë periudhës së monitorimit ka qenë protesta që një grup Personash me Aftësi të Kufizuara bënë fillimisht në Korçë e Pogradec dhe më pas në Tiranë, për të kërkuar rimbursimin që shteti u detyrohet për pagesën e kujdestarisë, për vitet 2010-2011. Kjo çështje u mediatizua më shumë kur protesta u zhvendos në Tiranë përpara MSHMS. RTSH, TCH dhe Euronews i kushtuan kronika në edicionet e tyre si dhe TCH i kushtoi dhe një kohë televizive më të madhe në emisionin e mëngjesit.

**Figura 11.** Tabela e temave të trajtuara në media

Tematika	Mediat	Zhanri
Protesta e Personave me Aftësi të Kufizuara për pagesën e prapambetur të kujdestarisë	Euronews RTSH TCH	Kronikë lajmesh Kronikë lajmesh Emisioni i Mëngjesit
Pjësëmarrja e një kandidati me Aftësi të Kufizuara në Listat për deputetë	TCH	Emisioni Top Story
Mungesa e një plani vaksinimi për kategori sociale	Euronews TCH	Kronikë Lajmsh Kronikë Lajmsh
Aksesi i Personave me Aftësi të Kufizuara në procesin zgjedhor	RTSH * 2 materiale ABC Euronews	Kronikë lajmsh Intervistë në studio Intervistë në studio
Mospërfshirja e çështjeve të Aftësisë së Kufizuar në programet e partive gjatë fushatës	Euronews	Kronikë Lajmsh

Tema e dytë më e trajtuar në vëmendje të hulumtimeve gazetareske ka qenë aksesi i Personave me Aftësi të Kufizuara në procesin e votimit. Kjo dhe për shkak të zërit që kanë ngritur disa herë organizata të shoqërisë civile që kujdesen për të drejtat e këtij komuniteti. Drejtues të këtyre OSHC-ve kanë dhënë disa intervista në media (RTSH,

Euronews dhe ABC), ku kanë paraqitur shqetësimet e tyre në lidhje me mungesën e aksesit në qendrat e votimit, por edhe për mungesë vëmendjeje në programet e partive politike. Po ashtu gazetarët kanë kryer edhe investigimet e tyre në terren ku kanë venduar raste konkrete të qendrave të votimit të vendosura në katet e dyta dhe pa asnjë akses alternativ për zgjedhësit me aftësi të kufizuara, sikurse në Shkodër në filialin e Postës Shqiptare ku ishin vendosur dy qendra votimi, referuar raportimit të gazetares së RTSH në edicionin qendror informativ të 15 Prill 2021.

Një tjetër shqetësim i ngritur nga përfaqësuesit e këtij komuniteti është mungesa e një plani vaksinimi të dedikuar për ta. Megjithëse OBSH i ka përfshirë Personat me Aftësi të Kufizuara si një nga kategoritë e rrezikuar më shumë gjatë pandemisë, sërish për ta nuk ka një strategji të posaçme vaksinimi. Gjatë fushatës elektorale janë ngritur disa herë zërat e OSHC-ve në lidhje më këtë problematikë, por reagimi nga ana e politikës ka qenë i vakët. Edhe pse në këto zgjedhje, Personat me Aftësi të Kufizuara kanë pasur në listat e kandidatëve për deputet një përfaqësues të tyre, vëmendja që media i ka kushtuar këtij kandidati ka qenë e pakët. Vetëm TCH i ka kushtuar disa minuta prezantimit të tij në një puntatë të emisionit Top Story ku evidentoheshin prurjet e reja në listat e kandidatëve dhe kandidateve për deputetë.

## VIII. PËRFUNDIME

Takimet Elektorale të kandidatëve dhe kandidateve për deputetë u pasqyruan përmes materialeve të gatshme të ofruara nga vetë subjektet politike në garë për zgjedhjet e 25 Prillit. Ky fakt kufizoi raportimin e medias në këndvështrimin e interesit të përgjithshëm publik dhe në veçanti të atyre grupeve të disavantazuara të shoqërisë sikurse Personat me Aftësi të Kufizuara.

Koha televizive kushtuar çështjeve të aftësisë së kufizuar është më pak se 1% e kohës totale të fashës prime time (18:00-24:00) dhe kryesisht konsistonte në transmetimin e aktiviteteve elektorale bruto (të plota) dhe në kronika të përgatitura për edicionet informative.

Gjatë periudhës së monitorimit nga 5 shkurti deri në 25 Prill u identifikuan vetëm 4 emisione që patën në vëmendje çështje të aftësisë së kufizuar përkatësisht 2 emisione në Top Channel, një intervistë në studio në ABC dhe një tjetër në studion e Euronews.

Raportimet për çështjet e Aftësisë së Kufizuar në median e shkruar dhe atë online ishin më të vakëta në raportimet e tyre kushtuar çështjeve të Aftësisë së Kufizuar krahasimisht me median elektronike (TV). Në total janë identifikuar vetëm 12 shkrime të publikuara tek Panorama, Koha Jonë, Balkanweb, Shqiptarja.com dhe ATSH. Të gjitha shkrimet kanë vetëm një burim informacioni: njoftimet për shtyp të shpërndara nga partitë politike ose postimet në rrjetet sociale të politikanëve.

Fjala kyçe më e ndeshur në raportimet televizive ka qenë “Persona me Aftësi të Kufizuara” e përdorur plot 95 herë, ndërsa në median e shkruar dhe online dominon fjala kyçe “invalid” e përdorur 18 herë.

Raportimet e takimeve elektorale në media shpeshherë kanë qenë jo etike për shkak të ashpërsisë së retorikës mes rivalëve politikë duke cënuar dhe ndjeshmërinë e Personave me Aftësi të Kufizuara, përkatësisht atyre që nuk shikojnë dhe dëgjojnë. Shkelje të etikës në media janë vërejtur edhe në transmetimin e deklaratave të një kandidateje e cila përdori për qëllime politike vdekjen e një personi invalid si dhe shfaqjen me fytyrë të të miturve me aftësi të kufizuara në takimet elektorale.

## IX. REKOMANDIME

Çështjet e Aftësisë së Kufizuar duhet të jenë më në vëmendje të medias, veçanërisht gjatë fushatave elektorale kur ky komunitet ka nevojë të jetë më i informuar në lidhje me aspektet konkrete të programeve të partive që lidhen drejtpërdrejtë me nevojat e tyre. Për këtë ka nevojë për vijimin e punës ndërgjegjuese me gazetarët por edhe me kryeredaktorët dhe drejtorët e informacionit të cilët përcaktojnë shkallën e vëmendjes së medias ndaj çështjeve të aftësi së së kufizuar.

Ashtu sikurse për kandidatet për deputete (vajza dhe gra), nevojitet më shumë vëmendje mediatike ndaj kandidatëve për deputetë që i përkasin komunitetit të Personave me Aftësi të Kufizuara me qëllim për të promovuar dhe nxitur aspiratat e tyre për të marrë pjesë në vendimmarrjen publike.

Gjatë fushatave elektorale, nevojitet të ruhet balanca mes materialeve filmike të gatshme të ofruara nga subjektet politike në garë për zgjedhjet dhe raportimeve të mirëfillta gazereske që nxjerrin në pah aspekte problematike dhe ngrenë shqetësime të kategorive të ndryshme sociale, mes tyre dhe Personat me Aftësi të Kufizuara.

Raportimet mediatike duhet të jenë më të kujdesshme nga pikëpamja etike edhe në ato raste kur etika shkelet nga vetë partitë që ofrojnë materialet e gatshme filmike.

Media e shkruar dhe ajo online duhet të qendrojnë më pranë me shkrime dhe raportime tematike për çështjet e Aftësisë së Kufizuar dhe jo vetëm pasqyrojnë aktualitetin, por të shkojnë përtej tij me ngritje problematikash dhe promovim të rasteve pozitive që ia kanë dalë të thyejnë tabutë dhe të vetë-realizohen përtej stereotipeve që ekzistojnë ndaj tyre.

## Referencat

- McLuhan Marshall, Instrumentat e komunikimit (Media si një zgjatim i njeriut), 2008
- Debord, G., “Shoqëria e Spektaklit”, 2009
- Electoral Knowledge Network, Komuniteti më i Madh Online për informacionet me karakter zgjedhor i prezantuar në Kombet e Bashkuara në vitin 1998 nga International Foundation for Electoral System
- Manuali i Drejtësisw, BIRN, Kapitulli “Liria e Shprehjes dhe e Medias” - <https://www.reporter.al/manualidrejtësisw/download/LIRIA%20E%20SHPREHJES%20DHE%20E%20MEDIAS.pdf>
- Peisazhi i Medias Online ne Shqipëri, Kap:Modeli i Biznesit Online”, fq.36, viti 2018  
<https://www.alex.com/topsites/countries/AL>
- Stand up, Speak out: The Practice and Ethics of Public Speaking, University of Minnesota Libraries Publishing, 2011, Kap. 13.2 Using Language Effectively
- Collins Dictionary - <https://collinsdictionary.com/dictionary/english/invalid>
- <https://www.oranews.tv/mur-qorr-rama-akuza-ademit-pakenaqesia-e-njerezve-ndaj-meje-per-shkak-te-qeverisjes-vendore/>